



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 133, Datë 04 / 12 / 2017

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me numër 115 Regj., datë 09.12.2016, të shtetasit L.M, kundër Shefit të Sektorit të Kujdesit Social, pranë Institutit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale¹ nr. 302 “Mine Peza”, Tiranë. Ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të gjendjes shoqërore².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Shtetasi L. M në ankesën e sjellë pranë Komisionerit informon se, prej dates 25.01.2016 ndodhet i paraburgosur pranë I EVP nr.302 “Mine Peza”, Tiranë. Ai pretendon se gjatë vuajtjes së paraburgimit është diskriminuar nga ana e A. K, me pozicion Shef i Sektorit të Kujdesit Social, pranë këtij Institucioni. Lidhur me këtë pretendim, sqaron se: “*Ndaj meje është ushtruar dhunë psikologjike dhe më janë shkelur të drejtat, në shenjë hakmarrjeje, vetëm se unë ankohesha për shkeljen e të drejtave. Me datë 01.12.2016 shkuam në bibliotekë, për zhvillimin e aktivitetit javor, të cilin e drejtonte Shefi i Sektorit të Kujdesit Social. Shoku i dhomës time, E. Xh i kërkoi sqarim Shefit për ditën e lirimit, pasi i takonte të lirohej me date 28.11.2016, dhe unë, me lejen e E, ndërhyra për të sqaruar kërkesën e tij tek Shefi i Sektorit. Z.K më ka fyer dhe ofenduar duke më prezantuar si person negativ pa qenë i tillë. Detyra e tij është për edukimin, rehabilitimin tone dhe jo të nxisë urrejtje midis të paraburgosurve apo të kryejë veprime diskriminuese ndaj meje*”. Ankuesi shprehet se këtë veprim e ka kryer në shenjë hakmarrjeje, vetëm se ai ishte

¹Në vijim do t’i referohemi me shkurtësën I EVP.

²Shtetasi L. M vuan dënimin me burgim pranë këtij Institucioni.

ankuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve³ për shkeljen e të drejtave të tij. Ankuesi kërkon nga Komisioneri të shqyrtojë ankesën e tij.

II. Ndjekja e procedures për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, **gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore**, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi për shkak të gjendjes shoqërore përbën shkak të mbrojtur nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, i cili parashikon se: “...“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Për sa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen, duke ndërmarrë hapat si mëposhtë:

1. Me shkresën nr.1217Prot, datë 30.12.2016 u njoftua IEVP “Mine Peza”, Tiranë, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës si dhe iu kërkuar informacion mbi pretendimin e ngritur nga ankuesi.

Me anë të shkresës me nr.4/1Prot., datë 09.01.2017, IEVP “Mine Peza”, Tiranë, informon Komisionerinse: “....Në Institucionin tonë nuk është paraqitur asnjë kërkesë apo ankesë nga ana e shtetasit L. M, lidhur me rastin e referuar. Pretendimet e tij nuk janë të vërteta dhe nuk qëndrojnë. Ndërkohë që ka vuajtur dënimin në IEVP “Mine Peza”, Tiranë, është proceduar për një vepër tjetër penale “Mashttrim” dhe për këtë është dënuar rishtaz”.

³Në vijim do t'ireferohemi me shkurtesën DPB.

Në vijim të përgjigjessë tyre, IEVP-ja sqaron se, shtetasi L. M ka shkuar në këtë Institucion në datën 17.01.2016 dhe në datën 23.12.2016, me Urdhër të DPB nr.9939/1, datë 19.12.2016, është transferuar, së bashku me dosjen e tij personale, në IEVP Fier.

2. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 30.01.2017⁴, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë IEVP-së “Mine Peza”, Tiranë.

Grupi i inspektimit të Komisionerit u takua me z. Albert Malaj, Drejtor i IEVP-së “Mine Peza”, Tiranë dhe A. K, Shef i Sektorit të Kujdesit Social, pranë këtij Institucioni. Lidhur me rastin e ankesës së shtetasit L. M, z.K sqaron se ankuesi (siç edhe ai shprehet në ankesën e bërë pranë Komisionerit) ka ndërhyrë për t’i kërkuar shpjegime për një të dënuar tjetër⁵, lidhur me datën e tij të lirimit nga IEVP-ja. Ndërkaq, z.K citon shprehimisht se: *“Në prezencë të gjithë të dënuarve të tjerë që kanë qenë në bibliotekë kam sqaruar shtetasin L. M se nuk është në kompetencën time të sqaroj të dënuarit lidhur me datat e tyre të lirimit⁶. Për këtë fakt duhet ti drejtoheni juristit të Institucionit”*. Nga ana tjetër, z.K thekson se nuk ka patur asgjë personale me ankuesin dhe se nëse do donte t’i bënte presion atij do e kishte thirrur në ambjente private, të veçuara dhe jo në prani të dëshmitarëve të tjerë.

Z.M informon se nuk ka asnjë ankesë, (me shkrim apo me gojë), të shtetasit L. M ndaj Shefit të Sektorit të Kujdesit Social apo ndaj personelit të këtij Institucioni, të depozituar pranë kësaj IEVP-je apo në DPB.

Z.K, lidhur me pretendimin e ankuesit për dhunë verbale dhe fyerje ndaj tij, sqaron se një pretendim i tillë nuk qëndron dhe është i pabazuar, pasi në çdo moment ai ka zbatuar procedurat dhe rregullat e parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, Rregulloren e Brendshme të IEVP-së, në përputhje me kompetencat që parashikohen në kuadër të punës që kryen Sektori i Kujdesit Social në IEVP.

3. Me shkresën me nr.1073 prot., datë 02.11.2017 iu kërkuar informacion shtesë IEVP “Mine Peza”, lidhur me verifikimin e faktit nëse ndaj punonjësit të këtij institucioni, A. K është paraqitur ndonjë ankesë nga shtetasi Lavdimir Muço apo nga të dënuar të tjerë të ndodhur pranë kësaj IEVP-je, për shkaqe të ndryshme.

Me shkresën me nr.1849/1 prot., datë 10.11.2017 IEVP “Mine Peza” Tiranë i është përgjigjur kërkesave të Komisionerit.

II. Vlerësimi i Komisionerit, i fakteve dhe provave të grumbulluara, gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

⁴Në zbatim të Urdhërit nr.8, datë 24.01.2017, të Komisionerit.

⁵Shtetasin E. Xh.

⁶Lidhur me këtë fakt ai i referohet kompetencave të përcaktuara në “Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve”.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë

(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)

Tel: +355 4 2431078

Fax: +355 4 2431077

e-mail: info@kmd.al

web: www.kmd.al

Lidhur me pretendimin e ankuesit se është diskriminuar për shkak të gjendjes shoqërore, nga ana e z.K, Shefi i Sektorit të Kujdesit Social të kësaj I EVP-je.

Ankuesi pretendon se z.K ka përdorur gjuhë fyese duke e ofenduar dhe duke bërë që ai të ndihej i diskriminuar. Nga ana tjetër, vetë z.K mohon që një pretendim i tillë të jetë i vërtetë, dhe se z.M nuk e ka ngritur më parë këtë pretendim, qoftë me gojë apo me shkrim.

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Në referim të dokumentacionit të siguruar gjatë inspektimit, rezulton se shtetasi L. M gjatë qëndrimit të tij në këtë I EVP ka marrë dy masa disiplinore. E para me datën 04.04.2016, me Vendimin nr.66/2 për “Kryerjen e veprimeve ose akteve me qëllime përfitimi” dhe e dyta me datë 13.09.2016, me Vendimin nr.233/3 për “Përdorim të fjalëve të pahijshme e fyese ndaj personave të tjerë”.

Nga këqyrja e procesverbalëve të mbajtura rezulton se ankuesi nuk i ka ankimuar masat disiplinore të marra ndaj tij dhe se ka kërkuar falje pasi ndihej i penduar.

Po ashtu, referuar shkresës me nr.1976 prot., datë 23.12.2016 të I EVP “Mine Peza”, Tiranë, në vlerësimin e sjelljes të shtetasit Lavdimir Muço⁷, citohet se: *“...I burgosuri ka shfaqur sjellje jo të mira dhe jo pozitive, është përfshirë në veprime që çënojnë qetësinë dhe rregulloren e burgut. Me stafin ka treguar marrëdhënie të mira dhe ka komunikim të mirë. Në raport me bashkëvuajtësit ka patur marrëdhënie jo të mira dhe jo pozitive, është përfshirë në debate dhe konflikte. Po ashtu është përfshirë në aktivitete që bien në kundërshtim me rregulloret. Nuk ka krijuar besimin e një qëndrimi korrekt. Ka treguar sjellje e qëndrim jo korrekt, prandaj dhe vlerësimi i tij ka qenë negativ”.*

Bazuar në librin e protokollit të I EVP “Mine Peza” për kërkesë-ankesat e paraqitura nga të dënuarit dhe të paraburgosurit, rezulton se ndaj punonjësit A. K nuk ka patur asnjë ankesë me shkrim as nga shtetasi L. M dhe as nga të dënuar të tjerë brenda këtij institucioni⁸.

Në nenin 49 dhe 50 të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ndryshuar me ligjin nr.40, datë 17.4.2014, është parashikuar në mënyrë të detajuar dhe e drejta e të paraburgosurve apo të dënuarve për të paraqitur ankesat e tyre, si dhe procedura që duhet të ndiqet për trajtimin e tyre. Kështu, është përcaktuar se: *“Pas*

⁷Përperiudhën e qëndrimit në Institucion: 25.01.2016 – 23.12.2016. Procesverbal është firmosur nga Komisioni, ipërbërënga: Përgjegjësi i Sektorit Ligjor, Përgjegjësi i Sektorit Social, Specialisti i Regjimit të Brendshëm, Shefi i Policisë.

⁸Shkresa me nr.1849/1 prot., datë 10.11.2017 e I EVP “Mine Peza”, Tiranë.

pranimit në institucion, i paraburgosuri dhe i dënuari informohen nga komisioni i pritjes lidhur me të drejtën për të paraqitur kërkesa ose ankesa, me shkrim ose përjashtimisht me gojë, drejtuar personelit të institucionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Ministrit të Drejtësisë, Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare, OJF-ve vendase dhe të huaja, gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit penal, prokurorit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, si dhe personave të tjerë që vizitojnë institucionin, sipas nenit 43 të këtij ligji. I paraburgosuri dhe i dënuari informohen për mundësinë e takimeve me drejtorin e institucionit, ose personelin përgjegjës për çështje në interes të tyre ose që përbëjnë shqetësim. Personeli i autorizuar organizon takime periodike me të paraburgosurin dhe të dënuarin, me qëllim krijimin e mundësive të paraqitjes së kërkesave ose ankesave. Rregullat dhe procedurat lidhur me shpeshësinë, kohën e takimeve dhe mënyrën e zhvillimit të tyre rregullohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Kërkesat ose ankesat, pasi regjistrohen në një regjistër të veçantë, i dorëzohen drejtorit të institucionit, i cili ngarkon punonjësën përkatës për zgjidhjen dhe kthimin e përgjigjes të paraburgosurve dhe të dënuarve. Çdo institucion mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave ose ankesave të të dënuarve dhe të paraburgosurve, në formë shkresore dhe elektronike. Formatit dhe përmbajtja e regjistrit, si dhe procedura për kthimin e përgjigjes përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Organet kompetente sipas këtij ligji shqyrtojnë ankesat dhe kërkesat sa më parë, por jo më vonë se 1 muaj nga paraqitja e tyre, përveç kur ka afate të posaçme me dispozita të veçanta. I burgosuri ka të drejtë të ankohet në instancat më të larta të sistemit të burgjeve dhe, kur kjo ankesë nuk zgjidhet në rrugë administrative, apo ndaj vendimit të dhënë, i burgosuri mund t'i drejtohet gjykatës së vendit ku ndodhet institucioni”.

Në rastin konkret, në përfundim të analizimit të ankesës, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioneri, nuk arrihet të provohet se ka patur veprime fyese apo diskriminuese nga ana e z.K, që ta kenë ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe dinjitoz.

Ligji nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ndryshuar me ligjin nr.40, datë 17.4.2014, lidhur me kompetencat e këtij sektori, në IEVP përcakton dhe fokusin e punës së tyre, duke përcaktuar se: “Organizimi i veprimtarive kulturore, çlodhëse e sportive duhet të synojë ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive fizike, shpirtërore dhe psikike të të paraburgosurit dhe të dënuarve. Për të dënuarit e mitur hartohet një program i veçantë përfshirjeje në veprimtari kulturore, krijuese e sportive, në bashkëpunim me të miturin. Administrata e institucionit bashkëpunon me institucionet e tjera, organizatat jofitimprurëse e ato fetare për organizimin e veprimtarive kulturore, krijuese dhe sportive, brenda dhe jashtë institucionit. Në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe riedukimit, sipas kërkesave të trajtimit, duhet të sigurohen mjediset dhe mjetet e përshtatshme dhe të nevojshme për zhvillimin e punës, arsimimin shkollor dhe profesional, veprimtaritë çlodhëse, kulturore dhe çdo veprimtari tjetër të përbashkët ose individuale. Institucionet duhet të jenë të pajisura me një bibliotekë librash dhe botime periodike.”.

Po ashtu, Rregullorja e Brendshme e IEVP “Mine Peza”, miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtorisë nr. 289/1, datë 07.06.2010, lidhur me detyrat funksionale të Shefit të Sektorit të Kujdesit Social përcakton specifikisht:

Neni 11, “Sektori i Kujdesit Social”

1. Sektori Kujdesit Social përgjigjet për veprimtarinë edukative dhe social-kulturore në institucion.

2. Sektori Kujdesit Social:

a) Ndjek rregullisht veprimtarinë sociale të të burgosurve dhe i pasqyron ato në protokollin e punës;

b) Harton planin mujor të veprimtarive social-kulturore dhe e dërgon atë për miratim tek Drejtori IEVP;

c) Harton relacionin mujor për veprimtarinë social-kulturore dhe raporton për të në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve;

d) Plotëson dhe administron të dhënat mbi gjendjen psiko-sociale për çdo të burgosur, duke përcaktuar karakteristikat e sjelljes për secilin prej tyre;

e) Mban kontakte të përditshme me të burgosurit për problemet e tyre;

f) Kujdesen për administrimin dhe shpërndarjen e korrespondencës së të burgosurve;

g) Kujdeset për punësimin e të burgosurve dhe përgatitjen profesionale të tyre në bashkëpunim me qendrat e formimit profesional si dhe me persona të tretë;

h) Kryen çdo detyrë tjetër të përcaktuar nga Drejtori IEVP.

2. Sektori i kujdesit social ka në përbërje të tij sipas rastit përgjegjësin e sektorit dhe specialistin e kujdesit social (punonjës social), *psikologun* dhe specialistin e edukimit. Përmbushja e detyrave të Sektorit realizohet sipas përgjegjësisve konkrete të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, kontratën individuale të punës ose të caktuara me urdhër të Drejtorit të IEVP .

Pra, sa më sipër nuk është në kompetencën e këtij sektori, të përgjigjet për anën ligjore të problematikave të ndryshme që mund të kenë të dënuarit në IEVP. Është Sektori Ligjor ai që kujdeset për zbatimin e akteve ligjore në fuqi, kryesisht, të atyre mbi funksionimin e strukturave të sistemit të burgjeve, gjatë veprimtarisë institucionale të IEVP. Kjo gjë është e përcaktuar në nenin 8, të Rregullores së Brendshme të këtij Institucioni. **Për rrjedhojë, pretendimi i z.Kazaferi se ai nuk kishte kompetencë dhe njohuri për t’ju përgjigjur ankuesit lidhur me datën e lirim të z.Xhafaj, duket i mbështetur dhe i bazuar në dokumentacionin provues.**

Lidhur me këtë argument, shohim se këto kompetenca i takojnë Sektorit Ligjor pranë kësaj IEVP-je.

Më specifikisht, citojmë:

2. Neni 8, “Sektori Ligjor”:

a) Bën zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe kontrollon zbatimin e tij nga strukturat e tjera të institucionit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre institucionale;

b) Ndjek dhe realizon mbrojtjen juridike të interesave të IEVP;



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë

(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)

Tel: +355 4 2431078

Fax: +355 4 2431077

e-mail: info@kmd.al

web: www.kmd.al

- c) Përgjigjet për plotësimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e dosjeve të të burgosurve, kontrillon dokumentacionin që gjendet në to në momentin e hyrjes në institucion, gjatë gjithë periudhës së vuajtjes së dënimit deri në lirimin e tij si dhe bën verifikimin e nevojshëm të saktësisë së dokumentacionit për lirimin në të burgosurit, duke marrë informacionin në rastet kur e çmon të aresyeshme nga Gjykata dhe Prokuroria;
- d) Kryen procedurat e nevojshme për lirimin në kohë të të burgosurve dhe në rast se konstaton tejkalim të afateve të mbajtjes në burg, informon menjëherë Drejtorin e IEVP;
- e) Administron sendet e të burgosurve që nuk lejohen të futen në regjimin e brendshëm të institucionit, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim;
- f) Përgatit dhe kontrollon ligjshmërinë e dokumentacionit të prokurimeve dhe ndjek realizimin e tyre;
- g) Përgatit përgjigjen për ankesat e të burgosurve, kur ka pretendime për cënim të standarteve ligjore të trajtimit të tyre si dhe ofron asistencë juridike për to, kur një gjë e tillë kërkohet me shkrim nga vetë i burgosuri;
- h) Mban evidenca të sakta për numrin dhe gjendjen gjyqësore të të burgosurve që ndodhen në IEVP;
- i) Kryen çdo detyrë tjetër të përcaktuar nga Drejtori IEVP

3. Përmushja e detyrave të Sektorit realizohet nga punonjësit e tij sipas përgjegjesive konkrete të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, kontratën individuale të punës ose të caktuara me urdhër të Drejtorit të IEVP.

Pra, pavarësisht sqarimit të situatës se nuk është në kompetencën e Sektorit të Kujdesit Social, e për rrjedhojë as në kompetencën e Shefit të këtij sektori, jemi në situatën kur nuk mund të provojmë apo të marrim si të mirëqena pretendimet e palës ankuese, se ka patur fyerje në drejtim të tij, për sa kohë ato janë të paprovuara shkresërisht, apo në mënyrë tjetër. Kjo për shkak se nuk ka asnjë ankesë të depozituar nga ana e z.M (ndryshe nga sa ngre pretendimin në ankesën e sjellë pranë Komisionerit), që të mund të provonte që vërtet ka patur një konflikt apo dhunë verbale, mes z.K dhe ankuesit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a) dhe, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të gjendjes shoqërore, të shtetasit L. M, kundër Shefit të Sektorit të Kujdesit Social, pranë IEVP-së “Mine Peza”, Tiranë.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë

(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)

Tel: +355 4 2431078

Fax: +355 4 2431077

e-mail: info@kmd.al

web: www.kmd.al

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha: të mira dhe shërbime

Shkaku: Gjendja shoqërore



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al

web: www.kmd.al